



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **82**

Prishtinë, më 28.8.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Etem Arifi.

Mungoi : Daut Haradinaj, Nait Hasani.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MBPZHR

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Liburn Aliu**, nënkryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 22.8.2012,
3. Shqyrtimi i gjendjes së pyjeve pas zjarreve të shkaktuara,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.8.2012

Nënkryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22.8.2012 duke veçuar veten sa i përket kërkesës së komisionit për MPB rreth sistemit të alarmeve të automjeteve të deputetëve.

3. Gjendja në pyjet e Kosovës

Nënkryetari i Komisionit Liburn Aliu në fillim njoftoi se fjala është për mbledhje urgjente për shkak të zjarreve në pyjet e Kosovës dhe njoftoi për vizitën e bërë të hënën tek bjeshkët e Koritnikut ku ka depërtuar zjarri nga Shqipëria dhe ku tani digjen pishat e kualitetit të veçantë (Robulli). Ai shtoi se në Dragash vatrat e reja të zjarreve dyshohet se kanë ndodhur me qëllim, ndërsa në anën tjetër komunat shumë pak kanë mundësi të luftojnë këtë dukuri jo të zakonshëm, sidomos kur dihet se zjarri është i kapacitetit të madh, edhe pse siç dihet kompetencat janë në anën e tyre që nga viti 2010 kur ka hy në fuqi ndryshimi i Ligjit për Pyje. Pasi që zjarri ende vazhdon si në Dragash ashtu edhe në Deçan, ai kërkoi kontributin e Komisionit sa i përket kërkesës që duhet ti drejtohet institucioneve përkatëse dhe kompetente por edhe ndërkombëtare siç është Komisioni Evropian për shkak të mungesës së pajisjeve të duhura në institucionet tona. Reagoi **Hetem Arifi** për shkak të deklarimit të zyrtarëve ndërkombëtarë në bisedë me Kryetarin e Komunës Dragash me deklaratën “të shohim si do ta menaxhoni dhe veproni ju me këtë situatë”, ngase edhe ata e dinë që ne nuk kemi kapacitetet që kërkohen në këto situata, ai mbështeti kërkesën për BE përmes zyrës së KE në Prishtinë.

Salih Morina mbështeti kërkesën e kryesuesit për ndihmë të gjithëmbarshme por shtoi se komunat nuk kanë kapacitete dhe buxhet, ndaj kërkohet sa më shpejt të vepronet.

Rasim Demiri falënderoi për kontributin që mundohet gjithkush ta jap në këtë moment dhe ceku se zjarri ndoshta ka mundur të parandalohet në periudhën prej 6 gushti kur është shfaqur në Shqipëri e deri më 21 gusht kur ka depërtuar në Kosovë duke formuar brezin kufitar, por meqë tani është gjendje alarmante është kërkuar intervenim me aeroplan nga Turqia dhe nga KFOR. Përndryshe, shtoi ai, kemi të bëjmë me pisha dhe drunj 600 vjeçare dhe shumë të vlefshme.

Sevdije Lama kërkoi formimin e TF (task forcës) pranë MB ose pranë Kryeministrisë për të mos ndodhur prapë situata të ngjashme siç është kjo. **Salih Morina** tha se këtë rol e ka Këshilli për Siguri Kombëtare i cili duhet të mblidhet urgjentisht.

Nijazi Idrizi konstatoi se Komunat kanë dështuar në realizimin e detyrave sipas Ligjit për Pyje, pyeti pse nuk është ftuar kryeshefi i APK, reagoi kryesuesi me arsyetimin se Komunat kanë kompetencat simbas ligjit ndaj për atë arsye janë kërkuar sqarimet nga Kryetari i Komunës, por është vizituar edhe zyra regjionale në Prizren Faruk Bojaxhiu i cili ka njoftuar se kryeshefi nuk është këtu.

Afërdita Berisha përkrahu kërkesat e parashtuara por insistoi që fillimisht të shteren mundësit vendore duke shfrytëzuar edhe popullatën, ngase nëse presim të ndihmoi dikush mund të jetë vonë, dmth krejt e para është të ndalet zjarri me ndihmën e qytetarëve. **Liburn Aliu** reagoi dhe sqaroi se në vatrat e paraqitura reagimi i qytetarëve ka qenë shumë i dobët sipas informatave të zyrtarëve komunal në Dragash, bile edhe FSK është penguar, si dhe njoftoi me ca shënime për sipërfaqen e përfshirë nga zjarri, e cila sipërfaqe është propozuar të bashkëngjitet Ligjit për parkun e Sharrit.

Hasan Ukaj nga Ministria e Bujqësisë fillimisht reagoi pse mungon përfaqësuesi i Komunës dhe konstatoi se bashkërisht jemi duke kontribuar për shkatërrimin e pyjeve tona. Vendet ku janë shfaqur zjarret sipas tij duhet ti dallojmë ngase prioritet për mbrojtjen e pyjeve në këtë rast duhet të ketë rajoni i Dragashit ku ndizen pishat shumë kualitative, ndërsa për Deçan tha se zjarri është shkaktuar pa qëllim (nga ata që punojnë nëpër livadhe) dhe nga operatorët ekonomik të papërshtatshëm, por nuk do të thotë se nuk ka edhe zjarre të qëllimshme. Në Bjeshkët e Belegut zjarri është lokalizuar, ndërsa Kleçka, Bellaja vështirë kalohen ngase drunj të ndezura rrëshqasin dhe shkaktojnë zjarre tjera deri tek gështenjat e Isniqit. Ai shtoi se Qeveria nuk ka ofruar as kushtet minimale për Komunat për ti mbrojtur pyjet përveç rojeve teknike ose ndonjë automjet aty këtu, çka do të thotë se Komunat janë zhveshur nga pajisjet teknike të duhura. Ai potencoi se edhe pompat e ujit janë të vlefshme ngase nëpër ato vende siç është Koritniku nuk ka mundësi të vepronet ndryshe, gjithashtu popullata duhet të jetë prezente me një organizim shumë më efikas. Ai nuk mohoi faktin se Komuna ka mundur të reagoi në periudhën prej 6 gushti deri 21 gusht kur është shfaqur zjarri në Kosovë. Reagoi **Nijazi Idrizi** dhe kërkoi njoftimin për gjendjen faktike në të gjitha komunat ku ndodhin zjarret duke mos dhënë komente të

panevojshme nga zyrtari i MB, por zyrtari i MB tha se nuk ka informata të mjaftueshme ngase ato janë kërkuar në një periudhë shumë të shkurtër si dhe nga fakti se ai sot është kthyer nga pushimi ndërsa të tjerët nuk janë në departamentin përkatës. Më tutje **Nijazi Idrizi** vazhdoi duke sugjeruar që komisioni të rekomandoi :

- të funksionalizohen komunat pas joefikasitetit dhe dështimit të plotë,
- ministria e bujqësisë të krijojë struktura për mbrojtjen e pyjeve të veçanta me vlerë duke i caktuar ato si prioritet,
- gjithashtu ministria të rekomandoi për infrastrukturë të nevojshme për të mos ndodhur prapë zjarre të ngjashme në vitet vijuese dhe bashkërisht me shtetet e rajonit të blihen disa aeroplanë,
- mekanizmat e mbrojtjes civile të ftohen në syqeltësi,
- ministrinë tjera kompetente dhe departamentet e emergjencës të janë më aktiv dhe të veprojnë me logjikë evropiane,
- komisioni të shfaqë brengën për gjendjen e krijuar duke kërkuar mbrojtje dhe masa urgjente për zonat e mbrojtura nga institucionet siç janë MMPH, MB, MPB-departamenti i shtabit emergjent, FSK dhe APK të cilat duhet të sugjerojnë masat e menjëhershme për tejkalimin e gjendjes së krijuar.

Përfaqësuesja nga Ombudspersoni insistoi në blerjen e aeroplanëve të cilat nuk janë edhe aq të shtrenjta sipas sajë, ngase vajtimi asgjë nuk sjellë.

Liburn Aliu sugjeroi të mbetet komisioni edhe pak mbas përfundimit të mbledhjes për të hartuar dy kërkesat, një të tjetër për Institucionet kompetente (për bashkëpunim me FSK), tjetër për zyrën e KE, mirëpo Komisioni autorizoi Kryesuesin dhe Koordinatorin që deri nesër ti hartoi kërkesat dhe paraprakisht të njoftohet Komisioni, pastaj të dërgohen ato.

Mbledhja përfundoi në orën 14,20.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Nënkryetari i Komisionit,
Liburn Aliu